

**INTERVISTA/Ambasadori i OSBE-së, Pavel Vacek, flet për "Panorama" për situatën në prag të zgjedhjeve vendore**

## **"Zgjedhjet, standardet s'varen nga moti"**

*Vacek: Pika të përbashkëta, jo polemika të kota me ndërkombëtarët*

*Intervistoi: Bledar Hoti*

**Z. Ambasador, si e gjykoni aktualisht situatën politike në Shqipëri. Kohët e fundit ka një deklaratë të Parlamentit Evropian, në të cilën shprehet shqetësimi për klimën politike të acaruar në Shqipëri. Cili është komenti juaj, çfarë vlerësimi i jepni aktualisht situatës politike në Shqipëri?**

"Unë jam gjithmonë i kufizuar për të bërë komente të tilla... Uroj që situatat të ishin më të favorshme ndaj reformave kyçe, në të cilat Prezenca e OSBE-së pritet të japë ndihmesën e saj".

**Duket se shkak për acarim është bërë afrimi i zgjedhjeve lokale. Një "betejë" kjo që pritet të nisë së shpejti, por maxhoranca dhe opozita ende nuk kanë realizuar atë çfarë faktori ndërkombëtar kërkon prej kohësh: realizimin e reformës zgjedhore. Si i gjykoni ju këtë situatë?**

"Nëse nuk gabohem, të dyja palët, edhe partitë e maxhorancës edhe ato të opozitës, kanë marrë angazhime për të punuar së bashku për reformën zgjedhore dhe për të ndjekur rekomandimet e mëparshme ndërkombëtare dhe është përgjegjësia e tyre e përbashkët për t'i përmbushur ato".

**Prej disa ditësh, prezenca e OSBE-së ka paraqitur disa propozime konkrete me qëllim zhbllokimin e punës së komisionit dhe realizimin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor. Cilat janë konkretisht ato dhe pse në këtë moment ndërmerret një hap i tillë. Ndërkohë, si i konsideroni ju akuzat e lëshuara në adresë të OSBE-së se këto rekomandime janë propozuar nga njerëz të PD-së dhe se janë në kundërshtim me raportin e OSBE/ODIHR-it?**

"Ju e keni fjalën për materialin i cili përmbledh parametrat minimalë të reformës zgjedhore që kanë të bëjnë me zgjedhjet për qeverisjen vendore, të cilat ishin të gjitha të bazuara mbi rekomandimet e mëparshme ndërkombëtare. Ky material u nda në mënyrë jozyrtare me bashkëkryetarët e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, si një mjet për t'ia rikujtuar këto çështje komisionit të posaçëm dhe, në këtë mënyrë, edhe për të mbështetur punën e tyre. Pse tjetër? A nuk ka mbaruar ndërkohë mandati i komisionit? Unë mendoj që gjëja më e mirë për akuzuesit është që më në fund

të kërkojnë pika të përbashkëta me kundërshtarët e tyre politikë dhe të mos kërkojnë polemika të kota me ndërkombëtarët...”

**Për shkak të bllokimit të procesit të reformës zgjedhore, maxhoranca shprehet se nëse nuk realizohet kjo reformë zgjedhore, në zgjedhje mund të shkohet edhe me Kodin aktual Zgjedhor, i cili nuk shmang një sërë problemesh, por mbi të gjitha të ashtuquajturën skemë të Dushkut? Sipas jush nëse ky dështim ndodh vërtet, a mund të shkohet në votime me Kodin aktual Zgjedhor?**

“Kjo është njëkohësisht një pyetje ligjore dhe politike, e cila duhet të adresohet nëse do të ndodhte në të vërtetë... dhe unë nuk dua ta paragjykoj një debat të tillë. Ndërkohë duhet bërë gjithçka për të lejuar reformën të realizohet. Dhe për pyetjen rreth Dushkut? Ju lutem, pyesni politikanët dhe ekspertët shqiptarë nëse dhe në çfarë mënyre fenomeni i Dushkut është i lidhur me këto zgjedhje vendore – dhe dua ta theksoj fjalën zgjedhje “vendore” – dhe se çfarë mase kërkojnë ata kundër këtij fenomeni...”

**Opozita ka kërkuar shtyrjen e zgjedhjeve, të cilat sipas ligjit duhet të mbahen nga data 20 dhjetor i këtij deri në 20 janar të 2007-s. Presidenti ka deklaruar se do të caktojë një datë brenda këtij afati, nëse nuk do të ketë marrëveshje mes palëve. Si e gjykoni ju periudhën kur qeveria kërkon të zhvillojë zgjedhjet, pra dhjetor-janarin? A garantohen standardet sipas jush?**

“Periudha prej një muaji për zgjedhjet vendore ka qenë e ditur gjatë gjithë kohës dhe kjo periudhë është e përcaktuar nga korniza ligjore. Nëse korniza ligjore nuk ndryshohet, ka një detyrim të përgjithshëm për të përgatitur zgjedhjet në datën brenda kësaj kornize të dekretuar nga Presidenti. Dhe standardet, dhe arritja e tyre apo jo – në njëfarë mënyre kjo ka shumë më tepër të bëjë me vullnetin politik për të shmangur praktikatat e këqija të së kaluarës se sa me motin... Që nuk do të thotë të mohojmë një gjë që dihet: është më e lehtë t’i organizosh ato dhe gjithashtu të marrësh pjesë në to kur temperatura është 20 mbi zero se sa 2 metër mbi borë. Por a nuk ka qenë e ditur kjo gjatë gjithë kohës?”

**Qeveria e maxhorancës së djathtë ka rreth një vit që po qeveris. Si ju duket sensi i kësaj qeverisje krahasuar me socialistët, sidomos si e vlerësoni luftën kundër korrupsionit? A shihni rezultate konkrete apo vetëm retorikë? Dhe si e gjykoni sjelljen e maxhorancës me institucionet Kushtetutës, si Prokurorinë, KLD-në apo Presidentin e Republikës? Si e vlerësoni qëndrimin e Presidentit për të mos e dekretuar shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm?**

“Unë nuk dua të bëj krahasime të tilla, të cilat nuk ndihmojnë. Sigurisht ne kemi punuar me qeveritë e mëparshme dhe ne jemi duke punuar me qeverinë e tanishme. Në këtë punë – e cila, e gjitha, ka për qëllim të mbështesë reformat në vend – ne kemi pasur progres në disa fusha, si p.sh. në reformën për pronat, në drejtësi, promovimin e barazisë gjinore dhe në bashkëpunimin e policive, për të kujtuar vetëm disa... Ne bëjmë më të mirën tonë për të qenë transparentë, dhe konsultohemi për planet tona, përfshirë këtu edhe buxhetin dhe unë besoj që kjo gjë vlerësohet. Dhe ne, padyshim, jemi gati për të vazhduar këtë punë...”